

PHI LAN THR OPY

edicioni 7

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI LAN THR OPY

hapësirë e dedikuar
për FILANTROPINË

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - dhjetor 2023

20

Rrathë Dhurues
2023

29

Smile.al

Publikohen shtatë
inicativat e reja

32

Intervista me
përfaqësues të
nismave filantropike
në vend

Richard Lukaj
Riges Beqiri



44

Fushata në ndihmë të
personave në nevojë

46

Fondacionet Komunitare

48

Zhvillime nga rrjeti
"Wings"

52

Zhvillime nga Evropa

Mirë se vini në edicionin e shtatë të revistës Philanthropy!

Revista "Philanthropy" prej tre vitesh tashmë, vijon të jetë një burim i rëndësishëm informacioni mbi zhvillimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri. Në këtë edicion, do të njiheni me nisma dhe aktivitete të reja të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm të ekosistemit, gjatë periudhës **korrik-dhjetor 2023**.

Një seksion të rëndësishëm në këtë edicion, zë prezantimi i gjetjeve të **monitorimit vjetor** të aktivitetit filantropik në Shqipëri. Ky raport ofron një pasqyrë të qartë të përpjekjeve dhe arritjeve në këtë fushë gjatë vitit 2023.

Në muajin dhjetor, u organizua me sukses ankandi i pestë i dhurimit, **"Rrathë Dhurues 2023"**, duke mbledhur një shumë prej **2,306,505 Lekë** në mbështetje të 4 nismave të reja komunitare, shumë e cila e tejkaloi objektivin e vendosur prej 1,200,000 Lekë në total. Eventi bëri bashkë individë, përfaqësues të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe medias të cilët ofruan mbështetje financiare, materiale, dhe konsulencë falas për zbatimin e katër nismave të prezantuara.

R
r
a
t
h
e
s
h



Në këtë periudhë, në platformën crowdfunding **Smile.al** u prezantuan shtatë nisma të reja në fushat e mirëqenies sociale, arsimit, trajnimit dhe inovacionit. Dhurimet nga individë dhe biznese do të ndihmojnë në adresimin e nevojave të komuniteteve lokale.

Gjithashtu, në këtë publikim kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me disa nga **nismat filantropike** të **Z. Richard Lukaj**, shqiptar i diasporës i cili prej më shumë se 25 vitesh kontribuon në drejtim të edukimit dhe ndërmarrjes së kauzave sociale në mbarë trojet shqiptare. Pjesë e kësaj rubrike është edhe një intervistë me **Z. Riges Beqiri**, përfaqësues i organizatës “Shoqata e Natyrës dhe Turizmit Bulqizë”, mbi nismën “Future, art, club”.

Fushatat më të suksesshme të ndërmarra në ndihmë të personave në nevojë, kanë një pasqyrim të dedikuar në revistë. Edhe në këtë edicion do të njiheni me disa prej tyre.

Në muajin nëntor, “**European Community Foundation Initiative**” – ECFI zhvilloi një takim në Berlin, me organizatat që mbështesin zhvillimin e fondacioneve komunitare në vende të ndryshme të rajonit, dhe Evropës. Diskutimet u fokusuan në vizionin dhe sfidat që ballafaqohen fondacionet komunitare në përpjekjet e tyre për zhvillim dhe qendrueshmëri.

Znj. Juliana Hoxha, Drejtore, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, ndau me anëtarët e rrjetit WINGS, zhvillimet më të fundit të aktivitetit filantropik dhe ekosistemit të tij në Shqipëri. Artikulli i plotë pasqyrohet në një nga rubrikat e këtij edicioni.

“Endowment & Foundation Mercer 2023” publikoi raportin “**Mat rrezikun, ndërto qendrueshmërinë**”. Ai pasqyron pikëpamjet e mbi 115 investitorëve të fondacioneve dhe institucioneve private, rreth sfidave kryesore, mbi investime në këtë drejtim dhe planet e të ardhmes.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek erexhepi@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A R R E T H A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K J A N A R - D H J E T O R 2 0 2 3


Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2023, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale, si dhe nga raportimet dhe publikimet e institucioneve publike dhe jo - publike. Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që kanë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.


Gjatë vitit 2023, u regjistrua një numër prej **104,158 dhurimesh** me një **vlerë dhurimi** prej **1,278,415,181 Lekë (12,351,837 Euro)**.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2022, ka një rritje të numrit të dhuruesve prej **40%**, ndërsa shuma totale e dhurimit është **trëfishuar** përafërsisht. Platformat crowdfunding online vijonë të jenë kanali kryesor i dhurimeve në vend.

Numri i dhurimeve sipas natyrës



Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë




Tre format kryesore të mbledhjes së dhurimeve janë përmes **Eventeve**,
Fushatave dhe në formë të **Drejtëpërdrejtë**.

Dhurimet sipas formës

128 dhurime në formë të **Drejtëpërdrejtë**

567 dhurime përmes **Eventeve**

103,463 dhurime përmes **Fushatave**



3 DHURUESIT KRYESOR

sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins (49)
- #2 OTP Bank Albania (27)
- #3 Banka Amerikane e Investimeve (22)

3 DHURIMET KRYESOR

sipas vlerës së dhurimeve

#1 ProCredit Bank 25,450,000 Lekë

ProCredit Bank rikonfirmon angazhimin në mbrojtje të mjedisit. Ndërtimi i Parkut fotovoltaik ProEnergy është një dëshmi e tij.

#2 Individë 20,285,348 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "Të Shpëtojmë Erjonën", në mbështetje të një vajze 6 vjeçare, e cila vuan nga leuçemia.

#3 Individë 17,413,935 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve "Të shpëtojmë jetën e Stefani Stambolliu!", e cila ndodhet në gjendje shëndetësore të rënduar.

3 DHURUESIT MË TË MËDHENJ

sipas vlerës së dhurimeve

- #1 Bankers Petroleum Albania 711,200,000 Lekë
- #2 Fondacioni Vodafone 2,860,000 Lekë
- #3 Banka Credins 1,250,738 Lekë

Fushata për ngritjen e fondeve

413
Thirrje për Dhurime

59
Fushata përmes
platformave
Crowdfunding

156
Fushata përmes Medias Sociale
& Platformave Crowdfunding

18
Megafushata

9
Fushata përmes
platformës Facebook për
Impaktin Social*


Evente

124
Evente live

64
Live Crowdfunding


*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri i dhuruesve sipas natyrës*



*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit




Përfituesit Përfundimtar



- Publik i gjerë (48.05%)
- Fëmijë dhe të rinj (46.45%)
- Individë/Familje (5%)
- Tjetër (0.3%)
- Më shumë se një kategori (0.1%)
- Kafshët (0.1%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (89.55%)
- Komunitet fetar (6.25%)
- Që jetojnë në vende të tjera (1.14%)
- Publik i gjerë (2.72%)
- Zonë Specifike (0.35%)




- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (50.99%)
- Të moshuar (43.06%)
- Gra dhe Fëmijë në risk (5.95%)



- Në vështirësi ekonomike, shëndetësore dhe sociale (67.03%)
- Zonë Specifike (18.22%)
- Të talentuar (2.96%)
- Fëmijë dhe të rinj (11.79%)

Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve

Gjatë vitit 2023, **98.08%** e dhurimeve u shpërndanë në Shqipëri, ndërsa pjesa tjetër jashtë vendit siç është paraqitur grafikisht më poshtë:



*Lushnjë, Durrës, Vlorë, Berat, Kukës, Fier, Gjirokastër, Pogradec, Përmet, Sarandë, Kavajë, Tropojë, Kolonjë, Tepelen, Malësi e Madhe.

Kosova



0.27%

Shtetas të huaj




0.63%

E panjohur




1.02%




Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve

82.06% e dhurimeve janë kryer nga dhurues nga diaspora, ndërsa pjesa e mbetur nga dhurues nga Shqipëria dhe shtetas të huaj.



* Fier, Shkodër, Mat, Dibër Korçë, Berat, Lushnje, Pogradec.




Gjatë vitit 2023 **5** fushat kryesore të dhurimeve janë si më poshtë:


Ndërkohë kategoria "Tjetër" përfshinë dhurimet e kryera për: Sportin(0.70%), Mbrojtjen e kafshëve(0.11%), Edukimin (0.11%), *Të Drejtat e njeriut/Angazhimin qytetar*(0.11%), Artin dhe kulturën(0.10%), Ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit (0.06%), Infrastrukturën publike(0.05%), Zhvillimin ekonomik(0.03%), Zhvillimin e komunitetit(0.02%), Aktivitete fetare (0.01%), etj.

Qëllimi i dhurimit

- Shëndetësi
- Zbutja e varfërisë
- Dhurime sezonale
- Mbështetje e grupeve të marginalizuara
- Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore
- Tjetër



Kanalet e dhurimit



Fjalorth



Gjatë vitit 2023, janë gjurmuar 964 artikuj në median e shkruar, audiovizive dhe atë sociale, të cilat mbulojnë fushatat dhe iniciativat dhuruese. Platforma më e zakonshme për këtë promovim ka qenë media sociale, Facebook, që është një nga kanalet e preferuara për shpërndarjen e informacionit rreth rasteve të dhurimit.

Njekohësisht, media vizive ka prodhuar një numër të konsiderueshëm emisionesh dhe reportazhesh të fokusuara në çështje të cilat kanë patur nevojë për mbështetje. Faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike kanë vazhduar të jenë një burim i rëndësishëm për promovimin dhe raportimin e zhvillimeve në fushën e dhurimit.

Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Përfituesit e dhurimeve apo iniciativave që kanë një impakt në publikun e gjerë.

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

Tjetër - Cdo kategori tjetër që nuk i përket kategorive të mëparshme.

20

R R A T H Ë D H U R U E S

6 D H J E T O R 2 0 2 3

Gjatë muajit dhjetor u organizua event i pestë "Rrathë Dhurues".


"Rrathë Dhurues" është një event i dhurimeve live, i cili u jep individëve mundësinë të bashkohen rreth një qëllimi filantropik për të mbështetur nisma komunitare.

Qëllimi kryesor i këtij eventi është nxitja e dhurimeve individuale dhe korporative për mbështetjen e nismave lokale të OJF-ve që synojnë një ndryshim social dhe një transformim pozitiv e të qëndrueshëm të komunitetit.



#RrathëDhurues
Shqipëri

RRATHË DHUR



Suksesi i eventit “Rrathë Dhurues” i tejkaloi edhe këtë vit pritshmëritë, duke dëshmuar fuqinë e bashkimit dhe ndjeshmërinë kolektive për të adresuar nevoja komunitare. Shuma totale e mbledhur prej **2,306,505 Lekë** e tejkaloi objektivin e vendosur prej 1,200,000 Lekë, duke rikonfirmuar ndjenjën e lartë të solidaritetit qytetar ndaj komuniteteve në nevojë.

Kontributet e mbledhura përmes eventit, dhe që ende vijojnë, do të mbështesin iniciativat e mëposhtme:

UES 2023



Rivitalizimi i “Sheshit Domino” në Fushë-Krujë

Fushë-Kruja, një qytet me sfida infrastrukturore, ka nevojë për një strategji të qëndrueshme për të përmirësuar atë. Një fokus i veçantë është në zonën e 'Sheshit Domino', e cila ka potencialin për t'u zhvilluar si një qendër tërheqëse për komunitetin.

Projekti për rivitalizimin e 'Sheshit Domino' synon të transformojë këtë hapësirë në një zonë të sigurtë dhe tërheqëse për të gjithë komunitetin. Përmes përpjekjeve të banorëve, veçanërisht të të rinjve, synohet përmirësimi i mjedisit, sigurisë dhe krijimi i një qendre të re për aktivitete kulturore.

Në këtë nismë komunitare do të përfshihen mbi 60 të rinj të cilët do të angazhohen direkt për zhvillimin e parkut, rekrutimin e vullnetarëve të tjerë dhe artistëve lokalë, si dhe organizimin e eventeve të ndryshme si “Dita e Tokës” me synim ndërgjegjësimin mbi çështjet mjedisore.

Rezultati kryesor është ndërtimi i një mjedisi të përmirësuar i cili do të frekuentohet nga rreth 10,000 banorë.

Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

Porta Rome per Integrim OJF

Banka Kombetare Tregëtare

Nr. Llogarisë: 423001795CLPRCLALLSË

Kodi Swift: NCBAALTX



E ardhmja për fëmijët

Kjo nismë komunitare synon të adresojë nevojën e fëmijëve në drejtimin e arsimit dhe përfshirjes shoqërore, të cilët vijnë nga familje të marginalizuara në qytetin e Korçës. Nisma trajton problemin e mungesës së modeleve pozitive në familje dhe të arsimit si prioritet në këto komunitete. Gjithashtu në këto familje, mungesa e ndërgjegjësimit për vlerat familjare, prindërimin si dhe mungesa e konsultimeve sociale bëjnë që fëmijët të jenë të ekspozuar ndaj sfidave të trafikimit, martesave të hershme dhe mungesës së integritetit në komunitet.

Përmes mbështetjes së synuar, do të mbështeten 100 fëmijë të grupmoshës 6-15 vjeç, përmes programeve të dedikuara të ofruara në 3 qendrat ditore për fëmijë, si dhe do të ofrohen trajnime mbi aftësitë për jetën për prindërit e tyre.

Nisma do të kontribuojë në vazhdimësinë e shërbimeve për fëmijët dhe familjet e tyre duke lehtësuar gjithashtu mundësinë e punësimit për prindërit e tyre.

Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

Misioni Emanuel

Intesa Sanpaolo Bank Albania

Nr. Llogarisë: 73426431801

Kodi Swift: USALALTR





Klasë burimore për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta

Numri i nxënësve me nevoja të veçanta në fshatin Shupenzë, Bulqizë është në rritje. Mungesa e materialeve burimore në mjediset shkollore dhe qendrat terapeutike të zhvillimit për grupin e fëmijëve me nevoja të veçanta, si dhe konteksti socio-ekonomik i zonës, kërkon nevojën urgjente për krijimin e një klase burimore për zhvillimin e nxënësve me nevoja të veçanta.

Nëpërmjet kësaj nisme komunitare synohet krijimi i një mjedisi të përshtatshëm zhvillues në mjediset e shkollës së mesme "Rifat Manjani", me materiale të përshtatshme didaktike, si dhe aktivitete të personalizuara për të zhvilluar jo vetëm inteligjencën, por edhe aftësitë sociale e emocionale të nxënësve, me qëllim integrimin e tyre me nxënësit tipikë.

Gjithashtu, synohet sigurimi i dy module testesh të standardizuara, përkatësisht "Moca" dhe "Vineland Adaptive Behavior Scale", për të vlerësuar aspektin konjitiv, emocional, social, komunikimin dhe aftësinë për zgjidhjen e problemeve të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Përmes kësaj ndërhyrjeje synohet ti vihet në ndihmë edhe mësuesve ndihmës dhe shërbimit psiko-social të shkollave duke patur mjetet e duhura didaktike dhe një mjedis të përshtatshëm.

Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

Shoqata e Natyres dhe Turizmit Bulqize
Banka Kombetare Tregtare
Nr. Llogarisë: 501007720CLTJCLALLDZ
Kodi Swift: NCBAALTX



Kutia e Periodës së Parë

Një komunitet i vogël, në zonën e Shkozës, përballet me shqetësime të rëndësishme lidhur me shëndetin riprodhues të vajzave në nevojë. Mungesa e burimeve materiale dhe informacionit për këtë grup, së bashku me stigma të theksuara rreth menstruacioneve, çojnë në mungesën e mbështetjes së nevojshme për vajzat adoleshente.

Kjo nismë komunitare synon të ndihmojë vajzat që vijnë nga familje me të ardhura të pakta ekonomike duke ndërtuar dhe shpërndarë "kuti të periodës së parë", për t'ju ofruar atyre jo vetëm materiale të nevojshme dhe të domosdoshme, por edhe njohuri edukative dhe mbështetje emocionale gjatë kalimit të fazës nga fëmijëria në adoleshencë.

Ndërhyrja do të konsistojë në ndërtimin dhe shpërndarjen e kutive të periodës së parë për vajzat, trajnime informative dhe ndërtimin e një kulture të hapur dhe mbështetëse rreth shëndetit riprodhues në komunitetin e zonës së Shkozës, në Tiranë.

Kjo nismë do të ndikojë në rritjen e kulturës dhe sjelljes pranë të komunitetit në lidhje me shëndetin riprodhues, eliminimin e stigmës dhe promovimin e një mjedisi më të hapur dhe të informuar rreth kësaj çështjeje.

Nëse dëshironi të kontribuoni dhe ju në këtë nismë, mund ta bëni duke kontaktuar organizatën zbatuese ose përmes llogarisë bankare:

Instituti për Zhvillim Strategjik
American Bank of Investment
Nr. Llogarisë: 002913561
Kodi Swift: EMPOALTR





7 dhjetor 2023 Edicioni i Lajmeve ne News24 ne studio Ina Qirjo (Ora 16.00)

News24 Albania 341K subscribers

Subscribe

9

Share

Save

...



Filantropia e "Rrathëve Dhurues"/ News 24, pjesë e "Hysenbelliu Group", ndoqi eventin

PANORAMA TV 119k subscribers

Subscribe

2

Share

Save

...



© 18-12-7 Dhjetor, 2023

f

Dhurimi është një akt që lumturon më shumë atë që dhuron. Me këtë ndjesi, mbrëmjen e djeshme, Kastari Group ofroi mbështetje përmes organizatave shqiptare, me qëllim që të përmirësojë jetën e atyre grupeve që duan vetëm pak ndihmë, për të patur një jetë dinjtoze.

ABC News

EVENTI NË FOKUSIN E
MEDIAS

syri

Syri.net







S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Shtatë nisma të OSHC-ve, u shpallën fituese në raundin e radhës së thirrjes për aplikime, dhe tashmë janë publikuar në platformën **Smile.al**. Përmes kontributit online nga publiku, dhurimet do të mbështesin nevojat e komuniteteve lokale të cilat adresohen përmes kauzave të prezantuara në platformë.

Ju ftojme të njiheni me nismat:

7 I N I C I A T I V A T



Mbështetje “sensoriale” për fëmijët me vështirësi në integrimin sensorial.

Projekti synon të pajisë 20 fëmijë me nevoja të veçanta (*me paralizë cerebrale, autizëm, Sindromën Down, dhe çrregullime gjenetike*), në zonat rurale të Tiranës dhe Durrësit, me një çantë me mjete didaktike sensoriale, duke synuar zhvillimin e aftësive motorike të këtyre fëmijëve. Kjo përfshin vlerësimin sensorial dhe trajnimin e prindërve për të punuar me fëmijët e tyre, brenda familjes dhe kontribuar kështu në zhvillimin e tyre. Ky inovacion do të ndikojë në reduktimin e izolimit të tyre në të ardhmen, duke ofruar një mundësi rehabilitimi, dhe angazhim të prindërve në kujdesin e tyre. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Shkëndija e fjalëve, logopedia për ndryshim.

Fëmijët me eksperiencë traumatike kanë probabilitet më të lartë për ngadalësim kognitiv dhe vështirësi në të folur. Kjo ndikon në ndërveprimin dhe marrëdhëniet sociale, theksuar nga vështirësitë në komunikim. Në "SOS Fshatrat e Fëmijëve", 19 fëmijë identifikohen që kanë nevojë për terapi logopedike për të përmirësuar aftësitë e tyre në të folur dhe ndikuar në zhvillimin e tyre të ardhshëm. Mbështetja juaj sot do të ndihmojë në rehabilitimin e këtyre fëmijëve. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Për një jetë të shëndetëshme dhe më ekonomike.

Motoja "Të jetojmë shëndetshëm dhe ekonomikisht më lirë" duhet të jetë pjesë e jetës së çdo familje në Shqipëri. Diskutojmë sfidat e taturës së energjisë, dhe nevojën për ujë të ngratë, duke lidhur këto sfida me fjalë kyçe si "energji e rinovueshme" dhe "eficiencë energjie". Edukimi qytetar dhe ndërgjegjësimi janë çelës për zgjidhjen e këtyre sfidave. Në Lushnjë, vendosja e paneleve diellore në institucione publike, nismë e ndërmarrë nga shoqata "Zëri Qytetar" është një hap para drejt ndërgjegjësimit për energjinë e rinovueshme. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)

E R E J A



Tinguj shprese.

Projekti "Tinguj shprese" synon të sjellë gëzim dhe shpresë për fëmijët e sëmurë në spitalin e Durrësit. "Lunah Qendra Edukimi" do të ofrojë aktivitete në fundjavë për këta fëmijë, bazuar në parimet Montessori, duke përfshirë muzikë, art, gjuhë të huaja, punë dore, kompjuter dhe animacion. Bashkohuni për të krijuar një të ardhme më të ndritshme dhe gëzueshme për këta shpirtra të rinj e të guximshëm në kohën e tyre më të vështirë. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Të verbër, por të etur për të lexuar.

Projekti "Të verbër, por të etur për të lexuar" shpreh pasionin për lexim të 3000 të verbërve, duke kërkuar ndihmë për ta ruajtur këtë pasion. Në 20 vitet e fundit, biblioteka ka ndihmuar mbi 3000 të verbër, për të siguruar akses në lexim, por sfidat financiare e vështirësojnë këtë përpjekje. Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, bën thirrje për ndihmën tuaj, e cila do të ndricojë mendjet e këtij target grupi. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



Sipërmarrësit e së ardhmes.

Investimet në infrastrukturën shkollore rriten vit pas viti, megjithatë, shkollat ende kanë nevojë. Ngritja e "laboratorëve të sipërmarrjes" do të ofrojë mundësi për zhvillimin e aftësive praktike të nxënësve, duke përdorur teknologjinë e informacionit, dhe mjedise miqësore për ta. Kjo nismë e Junior Achievement of Albania, përdor lojëra, mjete didaktike dhe platforma miqësore për fëmijët për ti ndihmuar të mësojnë në mënyrë praktike. Nga këto investime do të përfitojnë 320 nxënës në dy shkolla në Lezhë dhe Pogradec. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)



R.I.D.E. (Rruga gjithëpërfshirëse e Romëve drejt arsimit)

Projekti synon të integrojë fëmijët dhe adoleshentët e komunitetit Rom në Bashkinë Fier, duke adresuar sfidat e diskriminimit në nivele të ndryshme. Përmes nismave arsimore, synohet të sigurohet integrimi i tyre në sistemin shkollore duke siguruar transportin për në shkollë. Gjithashtu, projekti synon të promovojë dialogun ndërkulturor dhe harmoninë sociale përmes aktiviteteve artistike dhe sportive në Qendrën Rinore dhe Qendrën Sociale Murialdo. Kjo nisëm synon të ndikojë në rritjen e numrit të fëmijëve që vazhdojnë arsimin dhe zvogëlimin e braktisjes së shkollës nga komuniteti Rom. Për më shumë rreth nismës klikoni: [këtu](#)

I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D




M B Ë S H T E T J E

P Ë R

E D U K I M I N

Richard Lukaj



Themeluesi i Fondacionit Lukaj

Bankieri i shquar shqiptaro-amerikan, Z. **Richard Lukaj**, njihet për kontributin e tij filantropik në fushën e arsimit në mbështetje të një edukimi cilësor për të rinjtë. Megjithatë, aktiviteti i tij nuk fokusohet vetëm në këtë fushë. Z. Lukaj ka ndërmarrë dhe nisma të tjera, të udhëhequra përmes “Fondacionit Lukaj”.

Ju lutem mund të na tregoni se si ka nisur puna juaj dhe arsyet për të ndërmarrë nisma filantropike?

Që nga rënia e regjimit komunist në Shqipëri në vitin 1991, shqiptarët u përballën me sfida dhe ndryshime të shumta. Pamjet e dëshpëruara të emigrantëve shqiptarë, të cilët po kërkonin një jetë të re jashtë vendit, bënë tituj në media dhe nxitën nevojën për solidaritet. Edhe pse isha i ri, ndjeva një detyrim personal për të ndihmuar ata që ishin në situata të ngjashme me atë që kisha përjetuar unë dhe familja ime disa dekada më parë. Kështu, lindi "Albanian Relief Fund", një nismë e përkushtuar e shqiptarëve të diasporës për të kontribuar në rindërtimin e vendit.

Në këtë nismë, individë me aftësi, dhe eksperiencë të ndryshme, u bashkuan për të punuar në mënyrë të organizuar duke ofruar një platformë mbështetjeje dhe ndihmë për shqiptarët në nevojë. Kjo përpjekje pozitive ndikoi në jetën e tyre, e cila përveç kontributit material, ofroi një eksperiencë të pasur edukuese. Mobilizimi gjatë kohës së krizës tregoi se fuqia e bashkëpunimit kolektiv mund të ketë një impakt të jashtëzakonshëm në përmirësimin dhe zhvillimin e jetës së komunitetit, veçanërisht në një periudhë kur nevojat në Shqipëri ishin të mëdha.





Aktivitetet ndër vite

#Fondacioni Lukaj



Cili ka qenë target grupi i mbështetur dhe në cilat zona/ qytete është shtrirë mbështetja?

Faktikisht, ne kemi vendosur të mos publikojmë shumë mbi veprimtarinë tonë filantropike, pasi e konsiderojmë atë si një "detyrim moral". Edhe pse disa nga përpjekjet tona janë bërë të njohura për publikun, nuk kemi synuar t'i promovojmë ato në media.

Edukimi, ka qenë një nga prioritetet kryesore për mua personalisht dhe për familjen time. Edukimi i brezave, veçanërisht i të rinjve, ka qenë një përpjekje e qëllimshme, pasi besojmë se duke i mbështetur të rinjtë shqiptarë, ata gëzojnë të drejtën e një arsimit cilësor, dhe kontribuojmë në zhvillimin e potencialit të lartë intelektual të kombit tonë.

Familja ime dhe "Fondacioni Lukaj" angazhon burime të ndryshme për zhvillimin e arsimit duke ofruar bursa studimi për të rinjtë, të cilat akordohen çdo vit në Universitetin "RIT Kosovo" (A.U.K). Këtë nismë e kemi shtrirë edhe në universitete të tjera në rajon, duke bashkëpunuar me organizata si Fondacioni Shqiptaro – Amerikan "Trojet Tona" përmes së cilit vitin e kaluar kemi mbështetur me bursa 50 të rinj. Gjithashtu edhe me Fondacionin "Gjergj Kastrioti", kemi siguruar mbështetje financiare për studentët, të cilët kanë dëshirë të ndjekin studimet e larta në universitetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në një bashkëpunim të ngushtë me këto organizata, kemi ndihmuar studentët në kërkimin e mundësive për studime jashtë vendit, duke theksuar rëndësinë e përzgjedhjes së universiteteve cilësore. Roli ynë në këtë proces fokusohet në krijimin e partneriteteve me institucione dhe individë, të cilët përmes analizave të tyre, përzgjedhin ata që kanë me shumë nevojë për mbështetjen tonë.

Po ashtu, një prioritet i rëndësishëm është inkurajimi i pjesëmarrjes së grave në çdo sferë të jetës ekonomike, politike, sociale, etj. Kemi marrë pjesë në disa nisma mbi emancipimin e vajzave dhe grave dhe kemi punuar drejt krijimit të një mjedisi mundësues ku gratë të shpërblehen drejtë për aftësitë e tyre. Kjo është një pjesë e vizionit tonë për të ardhmen, duke përqendruar angazhimin tonë në krijimin e grave lidere në shumë fusha të ndryshme dhe inkurajimin e tyre për të marrë poste drejtuese në shoqëri.

Cili ka qenë impakti i arritur deri tani nga nismat e ndërmarra?

Dua të tregohem i drejtpërdrejtë, projektet tona kanë përjetuar një rrugë të gjatë zbatimi, duke përballuar sfida të ndryshme dhe duke sjellë rezultate të ndryshme për secilën prej tyre. Disa prej tyre nuk kanë arritur të ketë impaktin e dëshiruar, për shkak të faktorëve të ndryshëm që kanë ndikuar në zhvillimin e tyre me intensitet më të ulët. Megjithatë, ne mbajmë shpresën se këto nisma do të vazhdojnë të zhvillohen dhe do të gjejnë mënyra për të arritur ndikim pozitiv në të ardhmen.

Për shembull, krijimi i Universitetit RIT Kosova ka qenë një projekt i gjatë dhe sfidues. Edhe pse fillimisht kishim kapacitete të kufizuara dhe sfida të shumta, me gëzim konstatojmë se universiteti vazhdon të rritet vit pas viti, duke hapur degë të reja studimi dhe tërhequr studentë nga shumë qytete përtej Kosovës nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi etj. Kjo nisëm ka sjellë aktivitete dhe projekte që kanë një ndikim të dukshëm në jetën dhe zhvillimin e komunitetit universitar.

Në fushën e shëndetësisë, nisma "Action for Mothers and Children" ka shërbyer si dëshmi e përkushtimit tonë ndaj një shqetësimi social. Edhe pse kishte sfida në hapat e para, mbështetja jonë për këtë nismë ka ndihmuar në rritjen e kapaciteteve dhe zvogëlimin e vdekshmërisë së foshnjave. Përkundër vështirësive, nisma vazhdon të kontribuojë me sukses në shëndetin dhe mirëqenien e komunitetit.



Cili është plani juaj për të ardhmen?

Bordi i Fondacionit Lukaj, mbledhet çdo vit për të diskutuar prioritetet që dëshirojmë të mbështesim. Në kuptimin e sfidave të mëdha, vëmë re se nuk është gjithmonë e mundur të realizojmë të gjitha dëshirat tona, por mbetemi të angazhuar dhe jemi përpjekur të zgjerojmë kapacitetet tona. Për të rritur ndikimin tonë, kemi kërkuar bashkëpunim me familje të tjera dhe kemi arritur të amplifikojmë përpjekjet tona.

Gjithashtu, kemi ndërmarrë nisma për të afruar kapacitetet lokale në zonat ku dëshirojmë të ndërhyjmë. Dhurimet tona janë kryer kryesisht në rajon, duke u fokusuar në nevojat specifike të komuniteteve lokale, në vend të shpërndarjes së tyre në Amerikë. Kjo strategji ka pasuar sukses në përmirësimin e impaktit tonë dhe në adresimin e sfidave të veçanta të komuniteteve në nevojë



Riges Beqiri



Nisma #FutureArtClub

Z. Riges Beqiri, Drejtor ekzekutiv, Shoqata e Natyrës dhe Turizmit.

Pas mbarimit të studimeve në Fakultetin Ekonomik në Tiranë, ai është rikthyer në vendlindje për të ushtruar profesionin e tij dhe për të promovuar vlerat natyrore e kulturore të zonës. "Future Art Club" është ndër nismat e fundit që Z.Beqiri është angazhuar dhe ka realizuar së bashku me të rinjtë e qytetit.

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj, 'Future Art Club', dhe arsyet për të ndërmarrë një nismë të tillë?



'Future Art Club' është një nisëm inovatore, e cila u zbatua me sukses në tetor 2023 nga "Shoqata e Natyrës dhe Turizmit Bulqizë". Inspirimi për këtë nisëm erdhi gjatë pjesëmarrjes sonë në një event të programit "GLC Professional Fellows Program - Reunion 2023" të Ambasadës Amerikane në Tiranë, ku u bë e qartë se nevojitej një qasje të re për të përmirësuar komunitetin tonë. 'Future Art Club' u prezantua si një shans për të mobilizuar komunitetin në ndihmë të të rinjve të shkollës 'Xhevdet Doda' në Bulqizë, duke u fokusuar në zhvillimin e aftësive artistike përmes pikturës.

Qëllimi i kësaj nisme ishte mbledhja e një fondi vullnetar nga individë për të ofruar materiale pikturë për të rinj të talentuar. Duke pasur parasysh nevojën për nxitje dhe mbështetje në fushën e artit, 'Future Art Club' u shfaq si një mundësi për të sjellë ndryshime pozitive dhe zhvillim në komunitet. Ideja ishte të ofrohej një hapsirë ku talentet e reja do të mund të shfaqnin kreativitetin e tyre në pikturë dhe të zhvillonin aftësitë artistike. Kjo nismë u pa si një mjet për të shtrirë ndikimin pozitiv tek të rinjtë dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen aktive të komunitetit në përkrahje të zhvillimit artistik dhe kulturor të brezave të ardhshëm.

Cili ka qenë target grupi i mbështetur dhe në cilat zona është shtrirë mbështetja e 'Future Art Club'?

Target grupi i mbështetur nga "Future Art Club" është shkolla 9-vjecare 'Xhevdet Doda' në qytetin e Bulqizës, e cila përbëhet nga 465 nxënës. Qëllimi i nismës është thelbësor për të adresuar nevojat e një grupi të rëndësishëm në komunitet, duke iu ofruar një kënd të pasur artistik për zhvillimin e tyre.

Mbështetja ka konsistuar në ofrimin e materialeve të nevojshme për pikturë, duke përfshirë telajo, bojra, penela, dhe pajisje të tjera për punimet artistike. Përveç kësaj, mbështetja ka qenë e përqëndruar në inkurajimin e talenteve të të rinjve dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete artistike. Kjo qasje ka shërbyer si një mjet për të përmirësuar cilësinë e arsimit në drejtim të zhvillimit të kapaciteve artistike dhe për të sjellë frymëzim dhe motivim shtesë për nxënësit e kësaj shkolle.

Cili është impakti deri tani nga 'Future Art Club' dhe si ka ndikuar në target grupin?

'Impakti deri tani nga 'Future Art Club' ka qenë i madh. Pas dërgimit të materialeve të pikturës, nisma shpejt u materializua në konkursin e pikturës 'E dua Atdheun'. Nxënësit e shkollës morën pjesë aktivisht në këtë konkurs, duke prezantuar 73 punime të bukura.

Nxënësit, prindërit, bizneset, dhe autoritetet lokale u përfshinë në këtë aktivitet duke treguar mbështetje dhe admirim për krijimtarinë e të rinjve. Kjo ka sjellë një ndryshim jo vetëm fizik, por ka ndikuar edhe në mënyrën se si njerëzit vlerësojnë talentet e të rinjve. 'Future Art Club' ka sjellë një frymë pozitive, duke ndihmuar nxënësit të shohin artin si një mjet për shprehjen e emocioneve por edhe si një mënyrë për t'u zhvilluar individualisht.



F u t u r e A r t C l u b



Cilat janë planet e 'Future Art Club' për të ardhmen?

Shoqata synon vazhdimin e programit, duke u fokusuar në mbështetjen e talenteve të reja lokale. Rritja e bashkëpunimeve me komunitetin, institucionet vendore, institucionet qendrore dhe komunitetin ndërkombëtar është një hap i mtejshëm drejt mbështetjes së të rinjve. Zhvillimi i nismave të reja artistike, promovimi i tyre dhe organizimi i konkurseve janë pjesë e planeve tona për të ardhmen.

F U S H A T A
N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E N Ë
N E V O J Ë

Fushata

Disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve korrik - dhjetor 2023.

FONDACIONI MANE

MANE
FOUNDATION

TIRANA BANK



#2

“Fondacioni Mane” ka mundësuar mbështetje financiare për tre fëmijët e familjes “Likrama” në Krrabë të Tiranës. Gjithashtu me kontributin e Tirana Bank ka rinovuar shtëpinë e tyre

#1

Fondacioni “Fundjavë Ndryshe” përmes fushatës në ndihmë të familjeve në nevojë, mbledhi fonde për të ndihmuar Edlirën dhe vajzat e saj, të cilat rezikonin të ishin të pastreha.



#3

Nxënësit e shkollës “GDQ International Christian School”, Tiranë, kanë organizuar një fushatë për mbledhjen e ushqimeve në ndihmë të familjeve në nevojë në Tiranë.

FUNDJAVË NDRYSHE



#4

Miq të e “Qendrës Xhonatan” në Vjenë kanë organizuar një event bamirëse duke synuar mbledhjen e fondeve për të ndihmuar fëmijët me aftësi të veçanta në Shqipëri.



F O N D A C I O N E T K O M U N I T A R E

Në muajin nëntor, European Community Foundation Initiative (ECFI) organizoi në Berlin takimin e përvitshëm me organizatat mbështetëse për zhvillimin e fondacioneve komunitare në Evropë. Ky takim shërbeu si një forum diskutimi mbi çështjet dhe sfidat që përballen fondacionet komunitare, duke u fokusuar në rolin e organizatave mbështetëse në këtë drejtim.

FONDACIONET KOMUNITARE

Vitet e fundit, fondacionet komunitare në Evropë janë ndikuar në orientimin e kontributit të tyre si pjesë e krizave të ndryshme, politike, mjedisore, sociale dhe ekonomike globale. Gjithashtu, qëndrueshmëria e tyre shpesh herë është ndikuar nga besimi i publikut mbi kontributin e tyre. Për të përmirësuar qëndrueshmërinë, u dakortësua se nevojitet një komunikim më i hapur, transparencë ndaj mbështetësve dhe publikut, ndërhyrje strategjike dhe një menaxhim më i efektshëm ndaj skemave të mbështetjes.

Gjatë takimit u ktheksua nevoja për një qasje të re për të inkurajuar angazhimin e të rinjve dhe për të krijuar partneritete ndërkombëtare. Propozime për çështje si migracioni, angazhimi i të rinjve dhe përmbushja e “Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ)”, ishin disa nga fushat që ECFI do të adresojë gjatë vitit 2024. Gjithashtu, u theksua rëndësia e përdorimit të njohurive dhe eksperiencës ekzistuese midis vetë organizatave mbështetëse, duke përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.

ECFI Community Foundation Support Organisation (CFSO) Meeting

Berlin, 27-28 November 2023



Z H V I L L I M E T N G A R R J E T I W I N G S

WINGS është një forum për zgjidhje bashkëpunuese të problemeve, ku aktorët më të spikatur të ekosistemit mbi zhvillimet filantropike mund të ndajnë informacion dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. Rrjeti numëron më shumë se 180 organizata anëtare që shtrihen në 57 shtete, dhe Partnerët Shqipëri është organizata përfaqësuese për Shqipërinë.

Një dekadë ndryshimi në Shqipëri:

Juliana Hoxha, Drejtore, Partnerët Shqipëri

Në një botë që ndryshon me ritme të shpejta, filantropia shfaqet si një dritë shprese dhe ndryshimi. Në dekadën e fundit, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim ka dëshmuar dhe nxitur ndryshimet e e sektorit filantropik në Shqipëri. Ne kemi punuar për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e sektorit përmes kërkimit dhe monitorimit të rregullt të aktivitetit filantropik, edukimit të qëndrueshëm dhe krijimit të hapësirave që lehtësojnë dhurimin dhe nxisin angazhimin e komunitetit.



Kur filluam të punonim, "filantropia" në Shqipëri lidhej kryesisht me filantropët kryesor amerikan dhe jo me iniciativat lokale, pavarësisht nga një kulturë e pasur dhuruese gjatë shekullit të 19-të e shkatërruar brutalisht gjatë 45 viteve të komunizmit. Megjithatë, (jo)çuditërisht studimi ynë paraprak zbuloi kontribute aktive të sektorit privat për mirëqenien publike. Megjithatë studimi nxorri në pah disa pengesa strukturore dhe jo-strukturore për aktivitetin filantropik, si perceptimi i gabuar ose frika nga interpretimi i dhurimit si evazion fiskal dhe mungesa e besimit midis dhuruesve dhe përfituesve. Mungesa e infrastrukturës (platformave crowdfunding, etj) që ofron mbështetje dhe informacion se ku do të dhurohet dhe kush do të përfitojë e ka vështirësuar dhurimin. Një sfidë tjetër ishte mungesa e stimuljve fiskale për dhurimet individuale dhe të korporatave.

Panorama e sotme është krejt ndryshe, duke shënuar një përmirësim dhe zhvillim të madh në vetëm një dekadë. Edhe pse kuadri ligjor nuk tregon përparim të rëndësishëm, ndryshimet lidhen kryesisht me një kulturë filantropike në zhvillim nga korporatat dhe qytetarët në një mjedis të ri socio-ekonomik. Të gjitha këto zhvillime dhe analiza të rregullta ia sjellim publikut përmes revistës sonë "Philanthropy", e cila reflekton zhvillimet lokale dhe ushqen debatin mbi trendet dhe praktikatat globale.

Monitorimi ynë i rregullt i aktivitetit filantropik, i vetmi i këtij lloji, jep një pasqyrë të vlefshme për gjendjen e filantropisë në vend e cila vazhdon të ndërgjegjësojë dhe të stimulojë aktivitetin filantropik. Këto raporte, të publikuara çdo muaj që nga viti 2015, bazuar në të dhënat dhe faktet e raportuara nga media, platformat crowdfunding dhe faqet e internetit të agjensive qeveritare janë burimet më të mira për të vlerësuar zhvillimin e aktivitetit filantropik. Edhe pse të dhënat mund të jenë edhe më të sakta dhe vlera e dhurimit në vend pritet të jetë më e lartë se ajo e raportuar nga media, ato ofrojnë një bazë të mirë për të gjykuar trendet kryesore.

Duke analizuar pesë vitet e fundit (2019 – gjysma e parë e 2023), ne shohim një rritje të qëndrueshme eksponenciale të dhurimit, vit pas viti. Në vitin 2019, Shqipëria u godit nga një prej tërmeteve më të fuqishëm, me pasojë 51 jetë të humbura, 3000 të plagosur dhe dhjetëra mijëra qytetarë të mbetur pa strehë. Ky vit shënoi një dhurim rekord prej 12,5 milionë euro. Në vitin 2020, gjatë koronavirusit, pati një turrje të përkohshme të dhurimeve, e cila mund t'i atribuohet pjesërisht reduktimit të raportimit në media dhe performancës së dobët ekonomike të sektorit privat dhe ekonomisë familjare.

Aktiviteti filantropik u rrit sërish në vitin 2021 me 2,5 milionë euro dhurime që u dyfishuan pothuajse në vitin 2022 me 4,4 milionë euro dhe tashmë janë tejkalluar në gjysmën e parë të 2023 me një vlerë totale prej 9,6 milionë euro.

Ndërkohë që shohim një rritje të vlerës së dhurimeve, ka konsistencë ndër vite në qëllimin e dhurimit dhe përfituesit parësorë të tyre. Tre qëllimet kryesore të dhurimeve janë *zhdukja e varfërisë, përmirësimi i shëndetit dhe mbështetja në ofrimin e shërbimeve* për grupet e marginalizuara. Fëmijët dhe të rinjtë përbëjnë grupin më të madh të përfituesve, të ndjekur nga gratë në situata rreziku dhe të moshuarit.

Një trend i rëndësishëm zhvillimi në Shqipëri është mbizotërimi i dhurimeve nëpërmjet fushatave online dhe offline, krahas dhurimeve direkte. Në vitin 2022, rreth 87% e vëllimit total të dhurimeve u mundësua në këtë mënyrë, ndërsa për gjysmën e parë të 2023 ishte 99%. Platformat online si Facebook, Go Fund Me dhe platformat lokale si Smile.al dhe “Albanian Global Foundation” janë kanale të rëndësishme të përdorura nga dhuruesit individualë. Numri i dhuruesve ndjek të njëjtën ecure, duke shënuar një rritje të numrit të individëve në aktivitetin filantropik. Për ne dhe punën tonë, ky shënon një zhvillim të rëndësishëm dhe inkurajues, i cili flet për përfshirjen e shtuar të qytetarëve dhe forcimin e solidaritetit njerëzor.

Për ti shërbyer këtij qëllimi, Partnerët Shqipëri, gjatë katër viteve të fundit organizon eventin “Rrathë Dhurues”. Ky event bashkon individë nga fusha të ndryshme, duke ofruar ekspertizën e tyre, kohën dhe burimet financiare për të mbështetur kauzat konkrete që sjellin transformim pozitiv dhe të qëndrueshëm për individët dhe komunitetet specifike të synuara. Këto kauza propozohen nga organizata jofitimprurëse që punojnë në terren pas një përzgjedhje të bërë nga Partnerët Shqipëri.

Iniciativa si: nga monitorimi i filantropisë, çmimet e filantropisë, deri tek organizimi i “Rrathë Dhurues”, burojnë nga njohja e fuqisë transformuese dhe ndikimit kolektiv të filantropisë së drejtuar nga komuniteti. Përmes organizimit të “Rrathë Dhurues” qëllimi është krijimi i një kuadri të prekshëm dhe të qëndrueshëm që u mundëson individëve jo vetëm të dëshmojnë, por edhe të marrin pjesë aktive në procesin filantropik, duke nxitur një ndjenjë më të madhe pronësie, lidhjeje dhe ndikimi brenda komuniteteve.

Me angazhimin e një grupi besnik dhe të përkushtuar prej rreth 125 individësh nga sfera të ndryshme të jetës, 75 biznese dhe 25 organizata jofitimprurëse, nga viti në vit ne kemi trefishuar objektivin prej 8,600 euro dhurime për event. Suksesi ka të bëjë me ndjeshmërinë e nismave, si ofrimi i shërbimeve psikoterapeutike, edukative dhe sportive për 500 fëmijë dhe të rinj nga 18 – 25 vjeç, shërbime dentare falas për 400 fëmijë që jetojnë në zona të thella, ambiente rekreative për të moshuarit etj.

Ndikimi i dhurimeve dhe linjat transparente të komunikimit dhe llogaridhënies të vendosura ndërmjet përfituesve dhe dhuruesve gjithashtu kontribuojnë në suksesin e tij. Në katër vjet, “Rrathë Dhurues” kanë mbështetur 12 iniciativa komunitare në arsim, mjedis, shëndetësi, promovim të të drejtave të njeriut, aktivizëm rinor, sport dhe kulturë. Ato kanë ndikuar drejtpërdrejt në jetën e më shumë se 1500 fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve dhe kanë përmirësuar infrastrukturën e ndryshme duke nxitur mbështetje shtesë nga pushteti vendor dhe bizneset private lokale

Për të cituar shenjtoren tonë të dashur, “Nënë Terezën”, *“Jo të gjithë ne mund të bëjmë gjëra të mëdha. Por ne mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe.”*

Ne, Partnerët Shqipëri besojmë se edhe iniciativat e vogla dhe të vërteta mund të kalojnë në praktika transformuese për një ndikim më të gjerë shoqëror.

Z H V I L L I M E T N G A E V R O P A

“Endowment & Foundation Mercer 2023” publikoi raportin **“Mat rrezikun, ndërto qendrueshmërinë”**. Ai pasqyron pikëpamjet e mbi 115 investitorëve të fondacioneve dhe institucioneve private, rreth sfidave kryesore, mbi investime në këtë drejtim dhe planet e të ardhmes.

Anketa e "Endowment & Foundation" Merce 2023

Anketa e "Endowment & Foundation" Mercer 2023" nxjerr në pah se si mbi 115 investitorë të fondacioneve dhe institucioneve private po përballen me sfidat e pasigurisë ekonomike, duke vlerësuar rrezikun, diversifikimin e portofolit dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë afatgjate. Ky studim synon të avancojë bashkëpunimin dhe diskutimet rreth çështjeve kryesore të organizatave, duke përfshirë vendimet e fundit për investime dhe planet e ardhshme. Në kohë kur peizazhi ekonomik global përballlet me sfida si inflacioni, frika nga recesioni dhe rreziqet gjeopolitike, investitorët e fondacioneve dhe institucioneve private po eksplorojnë fushat e reja me një vigjilenc të shtuar.

Anketa identifikon katër fusha kryesore të fokusit që përbëjnë thelbin për këta investitorë:

- Rreziku dhe Qëndrueshmëria
- Ndarja e Aseteve
- Tregjet Private
- Qëndrueshmëria

Për më shumë lexoni [ketu](#).





Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania